



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.3 shkronjën d) dispozitat e nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale, nr. 03/L-040 publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.28/2008, Nenit 20 dhe 25 të ligjit Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, Nenit 10 dhe 40 të Statutit të Komunës, me kërkesën e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e X-të të rregullt të mbajtur më datën: 02.12.2022, merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Programit trevjeçar të Banimit 2022-2025

1. Miratohet Programi trevjeçar i banimit Banimi 2022-2025 në Komunën e Klinës.
2. Programi trevjeçar i banimit si në pikën 1 miratohet më qellim të ofrimit të kushteve me të mira dhe të përshtatshme për banim.
3. Pjese përbërëse e këtij vendimi është Programi trevjeçar i banimit në Komunën e Klinës
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas Rregullores së (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, përkatësisht 7 dite pas publikimit në ueb faqen e Komunës së Klinës.
5. Më këtë vendim njoftohet: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Zyra për informim dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr 06-91144/2022
Klinë, datë 07/12/2022



Kryesuesi,
Fadil GASHI